

## **VENDIM**

**Nr. 124, datë 05.03.2020**

### **PËR CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E NJË ÇËSHTJEJE GJYQËSORE TË VEÇANTË NË GJYKATËN E LARTË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

### **VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatën në nevojë si vijon:

#### **GJYKATA E LARTË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Sokol Binaj (relator), gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Astrit Kalaja si dhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Artur Kalaja, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Lartë, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; Objekti: “Kërkesë për përjashtimin e trupit gjykues të përbërë nga gjyqtarë jo të caktuar me ligj”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR  
KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**